MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.
Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë
Data: 02.02.26 Nr.: 01-338

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org. / Org. Jedin / Org Unit: 01/3
Nr. Prot. / Br. Prot / Prot.No: 434
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 0
Data / Datum / Date: 18.03.26
PRISHTINË
NO.1

# Raporti i Performancës për TM4- 2025 i KRUM-së

*Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt nr. 01-2026 të mbajtur me datë 02.02.2026 pas shqyrtimit të raportit, aprovoi Raportin e Performancës për TM4- 2025 dhe i njëjti dërgohet në NJPMNP.*

| | Delegoi | Aprovoi |
|---|---|---|
| Emri Mbiemri | Kryeshefi Ekzekutiv<br>Bashkim Kurti | Kryesuese e BtD-së<br>Kumrije Kelmendi Aliu |
| Nënshkrimi | | |
| Data | 02.02.2026 | 02.02.2026 |

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH. A.



# RAPORT PERIODIK I PERFORMANCËS TM4- 2025

Janar, 2026

## Përmbajtja

*1. HYRJE* ____ *5*

1.1 Përmbledhje e treguesve kryesorë ____ 5

1.2 Prodhimi dhe faturimi i ujit ____ 5

1.3 Të hyrat nga faturimi ____ 5

1.4 Inkasimi dhe efikasiteti komercial ____ 5

1.5 Shpenzimet operative ____ 5

1.6 Uji i pafaturuar (UPF) ____ 6

1.7 Mbulimi operativ ____ 6

Përfundim ____ 6

*2. SHËRBIMI ADMINISTRATIV* ____ *7*

2.2 Zyra Ligjore ____ 9

2.2.1 Punët përmbarimore ____ 9

*3. SHËRBIMI FINANCIAR* ____ *15*

3.1 Raporti Operativo – financiar ____ 15

Analiza e shpenzimeve dhe Inkasimit ____ 20

Inkasimi ____ 21

Krahasimi i indikatorëve kryesor *TM4 2025- TM4 2024* ____ 21

Raport i Progresit për Rivlerësimin e Aseteve ____ Error! Bookmark not defined.

*4 SHËRBIMI KOMERCIAL* ____ *23*

4.1 Përmbledhje ____ 23

*5. SHËRBIMI TEKNIK* ____ *27*

5.1 Distribuimi ____ 27

5.2 Kualiteti i ujit ____ 27

5.3 Kemikatet ____ 28

5.4 ITUN në Skenderaj ____ 29

*5.5 Raport i Njësive Operative* ____ 29

5.6 Planifikimi & Zhvillimi ____ 31

5.7 Punimet dhe Zhvillimet për Pjesë Veriore ____ 32

*6. IMPIANTI PËR TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA – PROJEKTI* ____ *35*

*7. ZYRA PËR INFORMIM RAPORTIM DHE MARDHËNIE ME PUBLIKUN* ____ *37*
7.1 Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun ____ 37
Monitorimi dhe informimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit ____ 37
Transparenca dhe qasja e barabartë në procedurat e punësimit ____ 37
Aktiviteti i ekipeve në terren ____ 38
Komunikimi i vazhdueshëm dhe përforcimi i besimit institucional ____ 38
Ngjarjet e veçanta në Dhjetor – Menaxhimi i turbullirës së ujit ____ 38
*8. PROKURIMI* ____ *39*

## Lista e tabelave

Tabela 1. Punët e kryera nga Sekretaria për Bordin e Drejtorëve për periudhën TM3 2025 ....7
Tabela 2. Hartimi i Rregulloreve dhe Procedurave ....7
Tabela 3. Lista e Aktiviteteve ....9
Tabela 4. Pasqyra e Aktiviteteve Përmbarimore sipas Përmbaruesit Privat ....9
Tabela 5. Përmbaruesi Privat – Ilmi Miftari....9
Tabela 6. Përmbaruesi Privat – Atip Mustafa....10
Tabela 7. Përmbaruesi Privat Fazli Gjonbalaj ....10
Tabela 8. Struktura e përgatitjes profesionale të punonjësve ....14
Tabela 9.Statistika; Profesionale dhe gjinore e KRUM sipas njësive ....14
Tabela 10. Raport gjithëpërfshirës mbi paditë....10
Tabela 11. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative - Mitrovicë ....15
Tabela 12. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Vushtrri ....16
Tabela 13. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Skënderaj ....17
Tabela 14. Indikatorët kryesorë të KRUM – Pa Veri dhe Zveçan....18
Tabela 15. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovicë veriore dhe Zveçan ....19
Tabela 16. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovica sh.a Total ....19
Tabela 17. Shpenzimet në përqindje të pjesëmarrjes në total të tyre....20
Tabela 18. Inkasimi sipas kategorive....21
Tabela 19. Krahasimi TM4 2025- TM4 2024....21
Tabela 20. Krahasimi me Plan të Biznesit....22
Tabela 21. Detyrat dhe Përgjegjësitë .... **Error! Bookmark not defined.**
Tabela 22. Krahasimi i Inkasimit&Faturimit për TM4 2024/TM4 2025 ....23
Tabela 23. Inkasimi & Numri i Konsumatorëve dhe Mesatarja e Inkasimit për Konsumator ....24
Tabela 24. Kontratat e Shërbimit dhe Riprogramimit - Krahasimi ....24
Tabela 25. Numri i Pagesave – Krahasimi....25
Tabela 26. Verifikimet dhe Montimet e Ujëmatësve ....26

Tabela 27. Ankesat dhe Kërkesat e Konsumatorëve (CRM) ........ 26
Tabela 28. Distribuimi i ujit nga ITU ........ 27
Tabela 29. Krahasimi i furnizimit nga ITU 2025 dhe 2024 ........ 27
Tabela 30. Sasia e kemikateve të shpenzuara gjatë muajve ........ 28
Tabela 31 Furinizimi me ujë sipas njësive operative ........ 29
Tabela 32. Parametrat e mirëmbajtjeve të rrjetit të ujit dhe kanalizimit TM2 ........ 30
Tabela 33. Të dhënat e inkorporuara në GIS ........ 31
Tabela 34. Kërkesat/Ankesat ........ 31
Tabela 35. Intervenimet në rrjetin e ujit –TM3 ........ 33
Tabela 36. Distribuimi i ujit nga ITU [3] ........ 33
Tabela 37. Distribuimi i ujit sipas vendbanimeve ........ 34
Tabela 38. Aktivitetet e Prokurimit ........ 39

# 1. HYRJE

## 1.1 Përmbledhje e treguesve kryesorë

**Koment mbi treguesit kryesorë – Krahasimi TM4 2024 vs TM4 2025**

## 1.2 Prodhimi dhe faturimi i ujit

Gjatë TM4 2025, prodhimi i ujit ka shënuar rënie prej **8%**, ndërsa faturimi në $m^3$ ka rënë për **7%** krahasuar me TM4 2024. Kjo rënie fizike nuk është reflektuar negativisht në të hyrat financiare, duke treguar përmirësim të strukturës së tarifimit, faturimit dhe menaxhimit komercial. Reduktimi i prodhimit dhe i volumit të faturuar reflekton gjithashtu masa të racionalizimit operacional dhe menaxhim më efikas të sistemit.

## 1.3 Të hyrat nga faturimi

Pavarësisht rënies së volumit të faturuar, **faturimi nga uji (€)** është rritur për **6%**, ndërsa faturimi total pa TVSH dhe me TVSH ka shënuar po ashtu rritje prej **6%**.
Faturimi nga shërbimet tjera, ndonëse me peshë të vogël në total, ka shënuar rritje të lartë relative (**52%**), duke reflektuar diversifikim gradual të burimeve të të hyrave.

## 1.4 Inkasimi dhe efikasiteti komercial

Inkasimi total është rritur ndjeshëm për **25%**, ndërsa norma e inkasimit është përmirësuar nga **82% në 97%**, që përbën një nga arritjet kryesore të TM4 2025.

## 1.5 Shpenzimet operative

Shpenzimet totale kanë shënuar rritje prej **39%**, kryesisht të ndikuara nga:

- **rryma elektrike**, e cila është rritur për **177%**, si pasojë e rritjes së çmimeve në tregun e lirë dhe shtrirjes së operimit,
- **pagat**, me rritje modeste prej **7%**, në përputhje me nevojat operacionale,
- rritje të kontrolluar në derivate, mirëmbajtje dhe kimikate, të lidhura drejtpërdrejt me zgjerimin e aktivitetit.

Shpenzimet ndaj Iber Lepenc kanë shënuar ulje prej **6%**, duke reflektuar optimizim të marrëdhënieve kontraktuale.

### 1.6 Uji i pafaturuar (UPF)

Në terma absolutë, uji i pafaturuar ka rënë për **9%**, megjithatë në përqindje ka mbetur në nivelin **51%**, që tregon se përmirësimi volumor është neutralizuar nga ndryshimet në prodhim dhe faturim. Ky tregues mbetet sfidë strukturore, e lidhur me amortizimin e rrjetit dhe nevojën për investime kapitale.

### 1.7 Mbulimi operativ

Mbulimi operativ ka rënë nga **109% në 98%**, si rezultat i rritjes së fortë të kostove të energjisë elektrike. Megjithatë, niveli prej 98% tregon se ndërmarrja ka arritur të mbulojë pothuajse të gjitha shpenzimet operative nga të hyrat e arkëtuara, duke ruajtur stabilitetin financiar edhe në kushte presioni të lartë të kostove.

### Përfundim

TM4 2025 karakterizohet nga **përmirësim i dukshëm i performancës komerciale dhe financiare**, rritje e arkëtimeve dhe disiplinës së pagesave, përkundër rritjes së konsiderueshme të kostove operative, veçanërisht të energjisë. Këta tregues konfirmojnë një tranzicion drejt një modeli më të qëndrueshëm financiar dhe një bazë më solide për vitet pasuese.

## 2. SHËRBIMI ADMINISTRATIV

Gjatë tremujorit Tetor–Nëntor–Dhjetor 2025, Sekretaria ka përgatitur procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe të Komisionit të Auditimit, të cilat pas përfundimit janë shpërndarë tek anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe aksionari.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Bordi i Drejtorëve ka zhvilluar gjithsej katër mbledhje, përfshirë një mbledhje të përbashkët me aksionarin dhe tri mbledhje të rregullta. Ndërkohë, Komisioni i Auditimit ka mbajtur katër mbledhje të rregullta.

Në kuadër të këtyre mbledhjeve, Bordi i Drejtorëve ka miratuar:

- rritjen e pagave për punonjësit e KRUM-ës; dhe
- dhënien e bonusit për stafin.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, Zyrtarja e Auditimit të Brendshëm ka paraqitur dorëheqjen, e cila është aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, ndërsa është marrë vendim për shpalljen e konkursit për plotësimin e kësaj pozite.

***Tabela 1. Punët e kryera nga Sekretaria për Bordin e Drejtorëve për periudhën TM4 2025***

| | Bordi Drejtorëve | Komisioni i Auditimit |
|---|---|---|
| Mbledhjet | 4 | 4 |
| Agjendat | 4 | 4 |
| Procesverbalet finale | 4 | 4 |

***Tabela 2. Hartimi i Rregulloreve dhe Procedurave***

| Nr | Data | Emri | Miratuar apo në proces |
|---|---|---|---|
| 1 | 03.11.2025 | Raportin e performancës për muajin korrik/gusht/ shtator 2025 | Miratuar |
| 2 | 03.11.2025 | Raportin e performances për TM3 2025 | Miratuar |
| 3 | 03.11.2025 | Planin e Biznesit 2026-2028 | Miratuar |
| 4 | 12.12.2025 | Rregullore për Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRUM | Miratuar |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 5 | 12.12.2025 | Rregulloren për Procedurat e Rekrutimit | Miratuar |
| 6 | 24.12.2025 | Raportin e performancës për muajin tetor/nëntor 2025 | Miratuar |

### 2.1 Burimet Njerzore

Gjatë tremujorit Tetor–Nëntor–Dhjetor 2025, Zyra e Burimeve Njerëzore ka realizuar aktivitetet kryesore që lidhen me administrimin dhe menaxhimin e marrëdhënieve të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e brendshme të kompanisë.

Gjatë kësaj periudhe është përgatitur dhe lëshuar dokumentacioni përkatës për stafin, përfshirë vendime administrative dhe dokumente të tjera të marrëdhënies së punës. Po ashtu, një punonjës ka përfunduar marrëdhënien e punës për shkak të pensionimit, me ç'rast janë përgatitur vendimet përkatëse sipas dispozitave ligjore.

Departamenti ka realizuar me kohë dhe pa vonesa procesin e pagave mujore për të gjithë punonjësit, duke siguruar saktësi dhe korrektësi në pagesa, si dhe ka ofruar mbështetje të vazhdueshme administrative për çështjet e personelit.

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar procedurat e konkurseve për pozitat **Menaxher i Përpunimit të Ujit – FTU Zubin Potok** dhe **Menaxher Operativ**, pas së cilave janë përzgjedhur kandidatët fitues dhe janë nënshkruar kontratat e punës.

Gjithashtu, janë përgatitur raporte progresi dhe dokumentacion lidhur me proceset e rekrutimit dhe prokurimit, si dhe është nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën **GIZ**, për mbështetje në rekrutim dhe përzgjedhje të stafit në pjesën veriore të vendit.

*Tabela 3. Lista e Aktiviteteve*

| Nr. | *Lista e aktiviteteve, veprimeve dhe vendimeve të cilat janë përpiluar, përfunduar/ ekzekutuar gjatë periudhës shtator* | |
|---|---|---|
| 1 | Përpilimi dhe hartimi i vendimeve për formimin e komisioneve të ndryshme brenda institucionit | 20 |
| 2 | Përgatitja dhe përpilimi i vendimeve për pushimet vjetore të stafit | 112 |
| 3 | Përgatitja e vendimeve të ndryshme administrative sipas nevojave të institucionit | 49 |
| 4 | Përpilimi i autorizimeve dhe vërtetimeve për punonjësit dhe palët e interesuara | 17 |
| 5 | Publikimi i konkurseve për vende të lira pune dhe ndjekja e procedurave të zhvillimit të tyre sipas legjislacionit në fuqi | 21 |

## 2.2 Zyra Ligjore

### 2.2.1 Punët përmbarimore

*Tabela 4. Pasqyra e Aktiviteteve Përmbarimore sipas Përmbaruesit Privat*

| Raporti TM-4 Tetor-Dhjetor | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Përshkrimi | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali |
| Pagesat nga kontratat në kompani | 1,860 | 1,860 | 2,983 | 6,704 |
| Kthimi i shpenzimeve nga përmbaruesi | - | 321 | 390 | 712 |
| Gjithsej: | 1,860 | 2,182 | 3,374 | 7,416 |

*Tabela 5. Përmbaruesi Privat – Ilmi Miftari*

| Përmbarues Privat - Ilmi Miftari | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Muajt | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali |
| Propozime | - | - | - | - |
| Përgjigje në prapësim | 1 | 1 | 1 | 3 |
| Ekzekutime / lëndë të përfunduara | 3 | 3 | 2 | 8 |
| Kontrata/Marrëveshje | 19 | 14 | 18 | |
| Vlera e Realizuar | 794.43 | 636.92 | 978.80 | 2,410.15 |
| Kthim takse | 62.62 | 70.80 | 81.42 | 214.84 |

### *Tabela 6. Përmbaruesi Privat – Atip Mustafa*

| Përmbaruesi Privat - Atip Mustafa | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Muajt | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali |
| Propozime | - | - | - | - |
| Përgjigje në prapësim | 10 | 1 | 29 | 40 |
| Ekzekutime / lëndë të përfunduara | 13 | 5 | 8 | 26 |
| Kontrata/Marrëveshje | 23 | 21 | 24 | - |
| Vlera e Realizuar | 1,423 | 1,277 | 1,650 | 4,350 |
| Kthim Takse | 345 | 111 | 270 | 726 |

### *Tabela 7. Përmbaruesi Privat Fazli Gjonbalaj*

| Përmbaruesi Privat - Fazli Gjonbalaj | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Muajt | **Tetor** | **Nëntor** | **Dhjetor** | Totali |
| Propozime | - | - | - | - |
| Përgjigje në prapësim | 1 | 1 | - | 2 |
| Ekzekutime / lëndë të përfunduara | 3 | 4 | - | 7 |
| Kontrata/marrëveshje | 13 | 4 | - | |
| Vlera e realizuar | 560 | 283 | - | 843.39 |
| Kthim takse | 12.36 | 120 | - | 132 |

### *Tabela 8. Raport gjithëpërfshirës mbi paditë*

| Nr. i lëndëve dhe emërtimi i paditësit dhe i të paditurit | Statusi/cilësia ligjore e palës në çështje | Periudha e kontesteve | Shuma/vlera e objektit të | Kamatat | Llogaritja e kamatave | Shuma e parashikuar nga 8% | Totali | Gjendja aktuale e shqyrtimit të lëndës | Pritshmëritë dhe rezultatet e pritura nga këto lëndë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. Nr. 3100/2019, A.A. Nr. 179/2021, ATK – Administrata Tatimore e Kosovës.** | Paditës | 2011/2012/2013 | 598,326 | 0 | | 598,326 | 598,326 | Lënda për ATK-në, e cila është në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti Komercial | Lënda ndodhet në Gjykatën Komerciale, dhe mundësia e zhvillimit të saj konsiderohet minimale. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| S.R. C.nr.435/16 | Paditës | 2013 | 800 | | | | | Jemi palë e paditur në padinë për lirim prone dhe në kundërpad i/kallëzim | Padia në këtë lëndë është në favor tonin. |
| **C.nr.435/18 M. I. Padi për kompenzim të të ardhurave personale** | Të paditur | 2018 | 3,000 | 0 | | | 3,000 | Lenda ne Lënda është në shqyrtim në Gjykatën Themelore | Kjo lëndë është në favor tonin. |
| **C.nr.7243/21 - S.M Padi për kompenzim dëmi dhe kthimin në vendin e punës** | Të paditur | 2021 | | 0 | | | - | Lënda është në shqyrtim në Gjykatën Themelore në | Mundësitë e rezultatit të lëndës konsiderohen të barabarta (50–50). |
| **C.nr.201/2022 B.L** | Të paditur | 2022 | 1,000 | | | | | Jemi palë e paditur në çështjen për kompensimin e gjashtë (6) pagave. | Gjasat që të ndodhë janë minimale, për arsye se i njëjti gjatë kësaj periudhe nuk ka kryer asnjë punë, ka pranuar pozicionin e ri, dhe në shkallën e parë kemi fituar këtë kontest. |
| **IV.EK.nr.239/20 Padi KEDS-it për kompenzim dëmi** | Padites | 2014 | 71,104 | 0 | 56,888 | | 127,992 | Kemi bërë padi ndaj KEDS-it për shkaktim dëmi. Lënda ndodhet në Gjykatën e Apelit, pas ankesës së paraqitur nga ana e KEDS-it, pasi që shkalla e parë e ka aprovuar padinë tonë për herë të dytë. | Gjasat që të ndodhë janë maksimale, për arsye se dy herë kemi fituar në shkallën e parë dhe ekspertizat janë në favorin tonë. |
| **02 -Nr.22-132/2022 C Inspektoriati i Punës** | Të paditur | 2023 | 500 | | | | 500 | Është ushtruar padi për konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale, Departamenti Fiskal, për shfuqizimin e vendimit të Inspektoratit.. | Mundësitë e rezultatit të lëndës konsiderohen të barabarta (50–50). |
| **Padi për Avestën – kompenzim dëmi, kontrata Nr. 22-13716-1-2-1/C84, për dëmin e shkaktuar për fabrikën e ujit në Shipol, klori jo i cilësisë së duhur** | Padites | 2023 | 161,245 | 0 | | | | Padi për shkaktim dëmi në Gjykatën Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike. | Jemi në fazën fillestare. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **C.nr.1129/2023 Padi për lirimin e pronës – Komuna e Mitrovicës, ish-prona e Administratës** | Paditës | 2023 | 5,000 | 0 | | | | Padi në Gjykatën Themelore në Mitrovicë për lirim prone. | Gjasat janë minimale për aprovim të kësaj padie. |
| **02-Nr.22-62/2022B Inspektoriati i Punës** | Të paditur | 2023 | 1,000 | 0 | | | | Padi për konflikt administrativ në Gjykatën Komerciale, Departamenti Fiskal, për anulimin e vendimit të Inspektoratit. | Mundësitë e rezultatit të lëndës konsiderohen të barabarta (50–50). |
| **02.V-77/23/1607 I Inspektoriati i Punës** | Të paditur | 2023 | 200 | 0 | | | | Padi për konflikt administrativ në Gjykatën Komerciale, Departamenti Fiskal, për anulimin e vendimit të Inspektoratit. | Mundësitë e rezultatit të lëndës konsiderohen të barabarta (50–50). |
| **TMS-MOBILE Shpk – Padi për kompenzim dëmi** | Paditës | 2024 | 6,356 | 0 | | | | Kjo padi është ushtruar pasi paditesi nuk ka përmbushur detyrimet e përcaktuara në kontratë për dorëzimin e kodit burimor dhe ka kryer shkeputje të njëanshme të kontratës. | Kjo padi besohet 90% të jetë në favorin tonë, në bazë të dokumenteve dhe letrave që posedojmë. |
| **C.nr 349/15 Ac.Nr.4244/17 C.nr1260/20** | Të paditur | 2014 | 5,280 | 0 | | | 5,280 | Ne kete raste jemi te paditur per demin eshkaktuar nga rrjedha e Ujite dhe bllokimi I kanalizimit, rrjedha eshte shkaktuar nga trepqa ndersa Kanalizmi nuk eshte pranuar nga KRUM | Në këtë lëndë, gjasat që të lirohemi nga përgjegjësia janë 95%, pasi lënda është në rigjykim dhe njëherë jemi liruar nga përgjegjësia. |
| **C.NR. - 394/2023 H. Q.** | Të paditur | 2023 | 1,196 | 0 | | | 1,196 | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat për festat. | Në këtë lëndë jemi humbës 100%, vetëm te kalkulimi i shumës mund të ketë ndryshime. |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **C.nr. 1609/21 M. R dhe D.D** | Të paditur | 2021 | | | | | | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat për festat. | Në këtë lëndë jemi humbës 100%, vetëm te kalkulimi i shumës mund të ketë ndryshime. |
| **C.nr. -396/2023 N. B.** | Të paditur | 2023 | | | | | | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat për festat. | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat e festave. |
| **C.nr. : 398/23 A.S.** | Të paditur | 2023 | | | | | | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat për festat. | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat e festave. |
| **C.nr.399/23F.L.** | Të Paditur | 2023 | | | | | | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat për festat. | Lënda është në procedurë kontestimore për pagesën e orëve shtesë gjatë vikendeve dhe pagesat e festave. |
| **C.nr.435/18 H.B** | Të paditur | 2018/2024 | 1,375 | 0 | | | 1,375 | Lënda në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. | Kjo lëndë është në favorin tonë. |
| **R- 2025 -XI-HK-HEKEMIJ-6 2025KE 48 -** | Pala e dëmtuar | 19.01.2025 | 62,189 | | | | | Lënda fillimisht është dorëzuar në sektorin e Krimeve Ekonomike, dhe pas dyshimeve të ngritura, është paraqitur në Prokurori me kallëzim penal nga Policia. | Kjo lëndë është në favorin tonë |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2021 KE 239 0082135 Objekti i Administratës** | Pala e dëmtuar | 2021 | | | | | | Lënda fillimisht është dorëzuar në sektorin e Krimeve Ekonomike, dhe pas dyshimeve të ngritura, është paraqitur në Prokurori me kallëzim penal nga Policia. | Në këtë lëndë janë 9 persona të dyshuar. |
| **P.NR. 610/2020 S.R.** | Pala e dëmtuar | | | | | | | Kallëzim penal për lirim prone në Suhodoll. | Jemi në fazën finale duke u përgatitur për fjalën përfundimtare. |

## *Tabela 9. Struktura e përgatitjes profesionale të punonjësve*

| Përgatitja profesionale | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Struktura** | **Master** | | **Baçelor** | | **E mesme/e lartë** | | **Shkolla Fillore** | | **Pakualifikuar** | | **Gjithsej:** | | **Totali :** |
| Nacionale | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M/F |
| Shqiptar | 16 | 6 | 23 | 13 | 160 | 11 | 12 | 1 | 8 | | 219 | 31 | 250 |
| Serb | | | | | | | | | | | | | |
| Malazez | | | | | | | | | | | | | |
| Turq | | | | | | | | | | | | | |
| Boshnjak | | | | | | | 1 | | | | 1 | | 1 |
| Ashkalinj | | | | | | | | | 1 | | 1 | | 1 |
| Gjithsej: | 16 | 6 | 23 | 13 | 160 | 11 | 13 | 1 | 9 | | 221 | 31 | 252 |

## *Tabela 10.Statistika; Profesionale dhe gjinore e KRUM sipas njësive*

| Përgatitjet Profesionale të Punonjësve | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2025** | Master | | Baçelor | | E mesme/e lartë | | Shkolla Fillore | | Pakualifikuar | | Gjithsej: | | Totali |
| **Njësit** | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | M | F | |
| **Mitrovicë** | 13 | 5 | 14 | 11 | 90 | 8 | 4 | | 4 | | 125 | 24 | 149 |
| **Vushtrri** | 2 | | 6 | 2 | 45 | 2 | 7 | 1 | 2 | | 62 | 5 | 67 |
| **Skenderaj** | 1 | 1 | 3 | | 25 | 1 | 2 | | 3 | | 34 | 2 | 36 |
| **Gjithsej:** | 16 | 6 | 23 | 13 | 160 | 11 | 13 | 1 | 9 | | 221 | 31 | 252 |

# 3. SHËRBIMI FINANCIAR

## 3.1 Raporti Operativo – financiar

*Tabela 8. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative - Mitrovicë*

| MUAJI | TM3-2025 | TM4-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 3,055,301 | 2,846,764 | (208,537) | -7% |
| Faturimi m3 | 1,279,159 | 938,703 | (340,456) | -27% |
| Faturimi nga uji € | 790,998 | 584,769 | (206,229) | -26% |
| Faturimi- te tjera € | 1,334 | 4,819 | 3,485 | 261% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 792,332 | 589,588 | (202,744) | -26% |
| Faturimi total me TVSH | **855,852** | 637,237 | (218,615) | -26% |
| Inkasimi nga uji € | 814,595 | 716,162 | (98,433) | -12% |
| Inkasimi - te tjera € | 2,898 | 6,446 | 3,548 | 122% |
| Inkasimi Total € | 817,493 | 722,607 | (94,885) | -12% |
| Nr. i Konsumatorëve | 24,515 | 24,819 | 304 | 1% |
| % e inkasimit | 96% | 113% | | 18% |
| Shpenzimet | 803,563 | 790,369 | (13,194) | -2% |
| Pagat | 374,275 | 346,061 | (28,214) | -8% |
| Rryma elektrike | 272,925 | 279,118 | 6,193 | 2% |
| Shpe. e derivateve | 5,153 | 5,267 | 114 | 2% |
| Miremb. Dhe riparimet | 21,518 | 23,330 | 1,812 | 8% |
| Kemikalet | 8,203 | 15,246 | 7,043 | 86% |
| Shp. - Iber Lepenci | 95,320 | 80,689 | (14,631) | -15% |
| Shpenzimet tjera | 26,169 | 40,658 | 14,489 | 55% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 1,776,142 | 1,908,061 | 131,919 | 7% |
| Uji I pafaturuar ne % | 58% | 67% | | 9% |
| Mbulimi operativ | **102%** | **91%** | | -10% |

*Tabela 9. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Vushtrri*

| MUAJI | TM3-2025 | TM4-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 2,067,673 | 1,622,886 | (444,787) | -22% |
| Faturimi m3 | 996,152 | 822,414 | (173,738) | -17% |
| Faturimi nga uji € | 546,875 | 468,573 | (78,302) | -14% |
| Faturimi- te tjera € | - | - | - | |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 546,875 | 468,573 | (78,302) | -14% |
| Faturimi total me TVSH | 590,625 | 506,059 | (84,566) | -14% |
| Inkasimi nga uji € | 665,597 | 528,145 | (137,452) | -21% |
| Inkasimi - te tjera € | 126 | 543 | 416 | 329% |
| Inkasimi Total € | 665,724 | 528,688 | (137,036) | -21% |
| Nr. i Konsumatorëve | 21,195 | 21,501 | 306 | 1% |
| % e inkasimit | 113% | 104% | | -8% |
| Shpenzimet | 472,212 | 466,114 | (6,098) | -1% |
| Pagat | 211,329 | 195,619 | (15,710) | -7% |
| Rryma elektrike | 191,048 | 195,383 | 4,335 | 2% |
| Shpe. e derivateve | 3,607 | 3,687 | 80 | 2% |
| Miremb. Dhe riparimet | 2,582 | 4,779 | 2,197 | 85% |
| Kemikalet | 3,058 | 5,645 | 2,587 | 85% |
| Shp. - Iber Lepenci | 43,839 | 35,662 | (8,177) | -19% |
| Shpenzimet tjera | 16,749 | 25,339 | 8,590 | 51% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 1,071,521 | 800,472 | (271,049) | -25% |
| Uji I pafaturuar ne % | 52% | 49% | | -2% |
| Mbulimi operativ | 141% | 113% | | -28% |

*Tabela 10. Indikatorët kryesorë të Njësisë Operative – Skënderaj*

| MUAJI | TM3-2025 | TM4-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 750,593 | 690,350 | (60,243) | -8% |
| Faturimi m3 | 271,325 | 249,866 | (21,458) | -8% |
| Faturimi nga uji € | 172,341 | 157,941 | (14,400) | -8% |
| Faturimi- te tjera € | 861 | 5,045 | 4,183 | 486% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 173,203 | 162,985 | (10,217) | -6% |
| Faturimi total me TVSH | 187,145 | 176,529 | (10,616) | -6% |
| Inkasimi nga uji € | 243,848 | 201,296 | (42,552) | -17% |
| Inkasimi - te tjera € | 2,584 | 2,595 | 11 | 0% |
| Inkasimi Total € | 246,432 | 203,892 | (42,541) | -17% |
| Nr. i Konsumatorëve | 10,002 | 10,212 | 210 | 2% |
| % e inkasimit | **132%** | **116%** | | -16% |
| Shpenzimet | 223,859 | 227,665 | 3,806 | 2% |
| Pagat | 112,661 | 111,446 | (1,215) | -1% |
| Rryma elektrike | 81,878 | 83,736 | 1,858 | 2% |
| Shpe. e derivateve | 1,545 | 1,580 | 35 | 2% |
| Miremb. Dhe riparimet | 2,116 | 2,799 | 683 | 32% |
| Kemikalet | 1,448 | 2,690 | 1,242 | 86% |
| Shp. - Iber Lepenci | 16,838 | 14,239 | (2,599) | -15% |
| Shpenzimet tjera | 7,373 | 11,175 | 3,802 | 52% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 479,268 | 440,484 | (38,785) | -8% |
| Uji I pafaturuar ne % | 64% | 64% | | 0% |
| Mbulimi operativ | 110% | 90% | | -21% |

*Tabela 11. Indikatorët kryesorë të KRUM – Pa Veri dhe Zveçan*

| MUAJI | TM3-2025 | TM4-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 5,873,567 | 5,160,000 | (713,567) | -12% |
| Faturimi m3 | 2,546,636 | 2,010,983 | (535,652) | -21% |
| Faturimi nga uji € | 1,510,214 | 1,211,283 | (298,931) | -20% |
| Faturimi- te tjera € | 2,196 | 9,863 | 7,668 | 349% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 1,512,410 | 1,221,147 | (291,263) | -19% |
| Faturimi total me TVSH | 1,633,622 | 1,319,825 | (313,798) | -19% |
| Inkasimi nga uji € | 1,724,041 | 1,445,603 | (278,438) | -16% |
| Inkasimi - te tjera € | 5,608 | 9,584 | 3,976 | 71% |
| Inkasimi Total € | 1,729,649 | 1,455,187 | (274,462) | -16% |
| Nr. i Konsumatorëve | 55,712 | 56,532 | 820 | 1% |
| % e inkasimit | 106% | 110% | | 4% |
| Shpenzimet | 1,499,634 | 1,484,148 | (15,486) | -1% |
| Pagat | 698,265 | 653,126 | (45,139) | -6% |
| Rryma elektrike | 545,851 | 558,237 | 12,386 | 2% |
| Shpe. e derivateve | 10,305 | 10,534 | 229 | 2% |
| Miremb. Dhe riparimet | 26,216 | 30,908 | 4,692 | 18% |
| Kemikalet | 12,709 | 23,581 | 10,872 | 86% |
| Shp. - Iber Lepenci | 155,997 | 130,590 | (25,407) | -16% |
| Shpenzimet tjera | 50,291 | 77,172 | 26,881 | 53% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 3,326,931 | 3,149,017 | (177,915) | -5% |
| Uji I pafaturuar ne % | 57% | 61% | | 4% |
| Mbulimi operativ | 115% | 98% | | -17% |

*Tabela 12. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovicë veriore dhe Zveçan*

| MUAJI | TM3-2025 | TM4-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 1,442,429 | 1,017,785 | (424,644) | -29% |
| Faturimi m3 | 1,442,429 | 1,017,785 | (424,644) | -29% |
| Faturimi nga uji € | 245,237 | 173,047 | (72,190) | -29% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 245,237 | 173,047 | (72,190) | -29% |
| Faturimi total me TVSH | 264,856 | 186,891 | (77,965) | -29% |
| Nr. i Konsumatorëve | 4 | 4 | | 0% |

*Tabela 13. Indikatorët kryesorë të KRUM – Mitrovica sh.a Total*

| MUAJI | TM3-2025 | TM4-2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 7,315,996 | 6,177,785 | (1,138,211) | -16% |
| Faturimi m3 | 3,989,065 | 3,028,768 | (960,296) | -24% |
| Faturimi nga uji € | 1,755,452 | 1,384,331 | (371,121) | -21% |
| Faturimi- te tjera € | 2,196 | 9,863 | 7,668 | 349% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 1,757,647 | 1,394,194 | (363,453) | -21% |
| Faturimi total me TVSH | 1,898,479 | 1,506,716 | (391,763) | -21% |
| Inkasimi nga uji € | 1,724,041 | 1,445,603 | (278,438) | -16% |
| Inkasimi - te tjera € | 5,608 | 9,584 | 3,976 | 71% |
| Inkasimi Total € | 1,729,649 | 1,455,187 | (274,462) | -16% |
| Nr. i Konsumatorëve | 55,716 | 56,536 | 820 | 1% |
| % e inkasimit | 91% | 97% | | 5% |
| Shpenzimet | 1,499,634 | 1,484,148 | (15,486) | -1% |
| Pagat | 698,265 | 653,126 | (45,139) | -6% |
| Rryma elektrike | 545,851 | 558,237 | 12,386 | 2% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Shpe. e derivateve | 10,305 | 10,534 | 229 | 2% |
| Miremb. Dhe riparimet | 26,216 | 30,908 | 4,692 | 18% |
| Kemikalet | 12,709 | 23,581 | 10,872 | 86% |
| Shp. - Iber Lepenci | 155,997 | 130,590 | (25,407) | -16% |
| Shpenzimet tjera | 50,291 | 77,172 | 26,881 | 53% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 3,326,931 | 3,149,017 | (177,915) | -5% |
| Uji I pafaturuar ne % | 45.5% | 51.0% | | 5% |
| Mbulimi operativ | 115% | 98% | | -17% |

## Analiza e shpenzimeve dhe Inkasimit

Shpenzimet për muajin raportues të paraqitura më poshtë paraqesin gjendjen reale të detajuar dhe të specifikuar në bazë të njësive operative dhe kumulativin e KRU "Mitrovica".

***Tabela 14.*** **Shpenzimet në përqindje të pjesëmarrjes në total të tyre**

| Shpenzimet | Vlera | % |
|---|---|---|
| Pagat | 658,416 | 44% |
| Energjia elektrike | 558,236 | 38% |
| Iber Lepenci | 130,591 | 9% |
| Kemikalet | 23,583 | 2% |
| Derivatet | 10,535 | 1% |
| ARRU | 12,913 | 1% |
| Shp. e perfaqesimit Ligjor | 1,397 | 0% |
| Mirembajtje | 30,908 | 2% |
| Te tjera | 57,568 | 4% |
| **Total** | **1,484,147** | **100%** |

## Inkasimi

### Tabela 15. Inkasimi sipas kategorive

| Kategoria | Inkasimi | % |
|---|---|---|
| Amvisni | 1,163,979 | 81% |
| Biznes | 202,635 | 14% |
| Ekonomi | 8,700 | 1% |
| Institucionet | 59,059 | 4% |
| Ndërkombtaret | 11,231 | 1% |
| **TOTALI 1** | **1,445,603** | **100%** |

## Krahasimi i indikatorëve kryesor *TM4 2025- TM4 2024*

### Tabela 16. Krahasimi TM4 2025- TM4 2024

| MUAJI | TM4 2024 | TM4 2025 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|---|---|---|---|---|
| Prodhimi m3 | 6,696,676 | 6,177,785 | (518,891) | -8% |
| Faturimi m3 | 3,252,940 | 3,028,768 | (224,172) | -7% |
| Faturimi nga uji € | 1,306,648 | 1,384,331 | 77,682 | 6% |
| Faturimi- te tjera € | 6,504 | 9,863 | 3,359 | 52% |
| Faturimi Total pa TVSH€ | 1,313,153 | 1,394,194 | 81,041 | 6% |
| Faturimi total me TVSH | 1,418,855 | 1,506,716 | 87,861 | 6% |
| Inkasimi nga uji € | 1,155,296 | 1,445,603 | 290,307 | 25% |
| Inkasimi - te tjera € | 8,588 | 9,584 | 996 | 12% |
| Inkasimi Total € | 1,163,885 | 1,455,187 | 291,302 | 25% |
| Nr. i Konsumatorëve | 52,353 | 56,536 | 4,183 | 8% |
| % e inkasimit | 82% | 97% | | 15% |
| Shpenzimet | 1,066,918 | 1,484,148 | 417,230 | 39% |
| Pagat | 610,523 | 653,126 | 42,603 | 7% |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Rryma elektrike | 201,451 | 558,237 | 356,786 | 177% |
| Shpe. e derivateve | 7,913 | 10,534 | 2,621 | 33% |
| Miremb. Dhe riparimet | 26,147 | 30,908 | 4,761 | 18% |
| Kemikalet | 15,649 | 23,581 | 7,932 | 51% |
| Shp. - Iber Lepenci | 138,568 | 130,590 | (7,978) | -6% |
| Shpenzimet tjera | 66,667 | 77,172 | 10,505 | 16% |
| Uji I pafaturuar në m3 | 3,443,736 | 3,149,017 | (294,719) | -9% |
| Uji I pafaturuar ne % | **51%** | **51%** | | 0% |
| Mbulimi operativ | **109%** | **98%** | | -11% |

## Tabela 17. Krahasimi me Plan të Biznesit

| | MITROVICE Jug | VUSHTRRI | SKENDERAJ | M.Veriore | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| Faturimi m3-(B.Plan) | 957,987 | 770,000 | 275,304 | 1,200,000 | 3,203,290 |
| Realizimi | 938,703 | 822,414 | 249,865 | 1,017,603 | 3,028,585 |
| % | **98%** | **107%** | **91%** | **85%** | **95%** |
| Faturimi €-(B.Plan) | 603,222 | 450,977 | 177,686 | 220,320 | 1,452,205 |
| Realizimi | 614,923 | 493,371 | 166,339 | 181,780 | 1,456,414 |
| % | **102%** | 109% | 94% | 83% | **100%** |
| Inkasimi nga uji-(B.Plan) | 630,034 | 466,427 | 187,906 | - | 1,284,367 |
| Realizimi | 716,161 | 528,144 | 201,295 | - | 1,445,600 |
| % | **114%** | **113%** | **107%** | | **113%** |

# 4 SHËRBIMI KOMERCIAL

## 4.1 Përmbledhje

Gjatë TM4 2025, Shërbimi Komercial ka vazhduar me aktivitetet e rregullta, duke përfshirë inkasimin, faturimin, inspektimin dhe veprimtari të tjera në përputhje me përgjegjësitë e këtij departamenti.

Në nivel të KRU-së, kemi shënuar:

- Rritje të inkasimit me **25.12%** krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar;
- Rritje të faturimit me **11.99%**;
- Një vlerë të inkasuar **290,307.02 €** më shumë sesa TM4e vitit të kaluar.

Gjatë TM4  janë zbatuar një sërë veprimesh me qëllimi përmirësimin e arkëtueshmëris, uljen e humbjeve dhe rritjen e transparencës së faturimit:

- Indetifikimi dhe legalizimi i konsumatorëve Ilega
- Leximi i saktë i ujëmatësve
- Dërgimi i vërejtjeve për borgjli
- Çkyçja e konsumatorëve debitor
- Rritje e numrit të konsumatorëve të regjistruar.

Këto rezultate reflektojnë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës financiare dhe efikasitetit të shërbimeve tona.

**Tabela 181. Krahasimi i Inkasimit&Faturimit për TM4 2024/TM4 2025**

| NJ.O | TM4 2024 | | | TM4 2025 | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Inkasimi | Faturimi | Shk.Inknë % | Inkasimi | Faturimi | Shk.Ink në % | Rritja në % e inkasimit 2025/2024 | Rritja ne € |
| Mitrovica | 574,699 | 598,081 | 96.09% | 716,162 | 631,496 | 113.41% | 24.61% | 141,463 |
| Vushtrria | 404,736 | 415,637 | 97.38% | 528,145 | 505,294 | 104.52% | 30.49% | 123,409 |
| Skenderaj | 175,861 | 153,655 | 114.45% | 201,297 | 170,598 | 117.99% | 14.46% | 25,436 |
| KRUM | 1,155,296 | 1,167,373 | 98.96% | 1,445,603 | 1,307,387 | 110.57% | 25.12% | 290,307 |

**Tabela 192. Inkasimi & Numri i Konsumatorëve dhe Mesatarja e Inkasimit për Konsumator**

| NJO | TM4 2025 | | |
|---|---|---|---|
| | Inkasimi | Numri konsumatorëve | Inkasimi mesatar/konsumator € |
| Mitrovica | 716,162 | 24,738 | 9.64 |
| Vushtrria | 528,145 | 21,342 | 8.24 |
| Skenderaji | 201,297 | 10,103 | 6.64 |
| KRUM | 1,445,603 | 56,187 | 8.57 |

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, mesatarja e të ardhurave të inkasuara për çdo konsumator është si më poshtë:

- **Mitrovica:** 9.64 €
- **Vushtrria:** 8.24 €
- **Skenderaj:** 6.64 €
- **Në nivel të KRU-së:** 8.57 € për konsumator

Këto shifra ofrojnë një pasqyrë të qartë të nivelit të inkasimit në secilin rajon, duke reflektuar performancën financiare të shërbimit në zona të ndryshme.

**Tabela 23. Kontratat e Shërbimit dhe Riprogramimit - Krahasimi**

| NJO | Kontrata –TM4 2024 | | Vlera | Kontrata –TM4 2025 | | Vlera € |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Shërbimi | Riprogramimi | Riprogramuar | Shërbimi | Riprogramimi | Riprogramuar |
| Mitrovica | 2,470 | 129 | 11,309 | 1,776 | 304 | 160.399 |
| Vushtrria | 862 | 31 | 18,152 | 1,703 | 189 | 131,388 |
| Skenderaji | 2,667 | 14 | 9,351 | 939 | 55 | 42,158 |
| KRUM | 5,999 | 174 | 140,512 | 4,418 | 548 | 333,946 |

Bazuar në të dhënat e tabelës së mësipërme, vihet re rritje e numrit të kontratave të riprogramimit. Megjithatë, vlera e borxhit të riprogramuar është **192,634 €** më e lartë krahasuar me tremujorin e të vitit të kaluar.

**Tabela 204. Numri i Pagesave – Krahasimi**

| | TM4 2024 | | | TM4 2025 | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| NJO | Numri i Pagesave | Vlera e Pagesave | Pagesa mesatare perkons.pagues | Numri I Pagesave | Vlera e Pagesave | Pagesa mesatare perkons.pagues |
| Mitrovica | 25,324 | 574,699 | 22.69 | 28,548 | 716,142 | 25.08 |
| Vushtrria | 19,928 | 404,736 | 20.30 | 23,140 | 528,145 | 22.82 |
| Skenderaji | 7,288 | 175,861 | 24.13 | 7,943 | 201,297 | 25.34 |
| KRUM | 52,540 | 1,155,296.27 | 21.98 | 59,631 | 1,445,584 | 24.24 |

Numri i pagesave është i përafërt me atë të periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Megjithatë, vlera e inkasuar ka shënuar një rritje prej **290.288€**, duke reflektuar përmirësimin e performancës financiare.

Në nivel të përgjithshëm, numri i pagesave është rritur nga **52,540** në **59,631**, me një rritje të vlerës totale nga **1,155,296 €** në **1,445,584 €,** ndërsa pagesa mesatare ka kaluar nga **21.98 €** në **24.24 €.**

Në vijim, paraqiten aktivitetet dhe aksionet e realizuara në terren, të cilat përfshijnë identifikimin e konsumatorëve ilegalë, regjistrimin e konsumatorëve të rinj dhe veprime të tjera relevante.

***Tabela 25. Të dhënat e ndryshme***

| TM4 2025 Nj.Operative | Konsumator Ilegal | Paushall - ujëmatës | Ujmates të Përbashkët në Individual | Konsumator të rinj | Ndrrim ujëmatësi | Konsumator të pasivizuar |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Mitrovicë** | 6 | 213 | 8 | 304 | 106 | 30 |
| **Vushtrri** | 14 | 74 | - | 306 | 65 | - |
| **Skenderaj** | 5 | - | - | 214 | 30 | 4 |
| **Totali:** | 25 | 287 | 8 | 824 | 201 | 34 |

Aktiviteteve të kontrollit nuk u kanë munguar, por identifikimi i kyçjeve ilegale tek konsumatorët ka qenë shumë i vështirë, pasi që jemi në sezonin dimëror dhe të gjitha kyçjet izolohen dhe nuk shfrytëzohen. Nga fillimi i TM2kemi filluar me aktivitete më të shpeshta dhe më të detajuara rreth keqpërdorimeve.

### Tabela 26. Verifikimet dhe Montimet e Ujëmatësve

| Njësit Operative | Verifikime | Montime |
|---|---|---|
| Totali | 5,000 | - |

### Tabela 27. Ankesat dhe Kërkesat e Konsumatorëve (CRM)

| Ankesat/Kerkesat Komerciale | Ankesat Komerciale | Kërkesat Komerciale |
|---|---|---|
| Totali | 52 | 309 |

# 5. SHËRBIMI TEKNIK

## 5.1 Distribuimi

Gjatë tre mujorit të katërt 2025, ITU në Shipol janë distribuar 4,554,899 $m^3$ dhe ITU Balinc 1,622,886 $m^3$,që në total kanë distribuar 6,177,785 $m^3$ siç shihet në tabelën me poshtë. Ndërsa kur krahasohet me vitin e kaluar për te njëjtit muaj është distribuar për 518,891 $m^3$ më pak, siç shihet ne tabelën në vijim.

***Tabela 28. Distribuimi i ujit nga ITU***

| Uji i prodhuar-ITU | Shipol $m^3$ | l/s | Balinc $m^3$ | l/s | Zubin Potok $m^3$ | l/s | Totali $m^3$ |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| TM1 | 4,830,203 | 621.168 | 1,744,699 | 224.369 | - | | 6,574,902 |
| TM2 | 4,932,708 | 627.379 | 1,928,915 | 245.334 | - | | 6,861,623 |
| TM3 | 5,248,323 | 660.266 | 2,067,673 | 260.123 | 1,049,388 | 132.018 | 7,315,996 |
| TM4 | 4,554,899 | 573.029 | 1,622,886 | 204.167 | 1,078,301 | 135.655 | 6,177,785 |
| Total | 19,566,133 | | 7,364,173 | | 2,127,689 | | 26,930,306 |

***Tabela 29. Krahasimi i furnizimit nga ITU 2025 dhe 2024***

| Uji i prodhuar ITU-të | Viti 2025 $m^3$ | Viti 2024 $m^3$ | Diferenca $m^3$ |
|---|---|---|---|
| TM1 | 6,574,902 | 6,765,491 | -190,589.0 |
| TM2 | 6,861,623 | 6,991,572 | -129,949.0 |
| TM3 | 7,315,996 | 7,554,200 | -238,204.0 |
| TM4 | 6,177,785 | 6,696,676 | -518,891.0 |
| Total | 26,930,306 | 28,007,939 | -1,077,633.0 |

## 5.2 Kualiteti i ujit

Gjatë tre mujorit sipas raportimeve nga menaxherët e fabrikave duke u bazuar në rezultatet e analizave fiziko-kimike ne laboratorët e fabrikave tona, rezultatet kanë qenë në suaza normale të standardeve për ujë te pijes. Kualiteti i trajtimit të ujit, dëshmohet edhe me analizat e kryera nga IKSH në Kosovë, dega në Mitrovicë,të cilat përputhen me vlerat e gjetura në ujin e pa përpunuar dhe të përpunuar në laboratoret tona. Instituti ka verifikuar edhe shume mostra tjera të kualitetit të ujit të cilat kanë rezultuar me kualitet të lartë të ujit në rrjetin e ujësjellësit në tërë rajonin. Njëkohësisht disa parametrat bazik kontrollohen edhe në mënyrë digjitale 24 orë.Me përjashtim

të defektit nga punimet në kanalin Ibër-Lepenc, defekt ky i cili na detyroi ndërprerje të furnizimit me ujë deri në stabilizim të gjendjes.

Duhet të theksohet se IKSH në Mitrovicë ka qenë aktive dhe kemi arritur marrëveshjen e shërbimit mbi kontrollimin e kualitetit të ujit, në mes të KRU Mitrovica" dhe këtij instituti.

## 5.3 Kemikatet

Gjatë tre mujorit të katërt, për trajtim të ujit të pa përpunuar është përdorur si koagulant kloruriferrik, ndërsa si dezinfektues klori i gazët në të dy ITU-të. Nga tabela më poshtë shihet se gjatë tre mujorit të tretë, shpenzimi për trajtim të ujit të pa përpunuar janë: **196,194 kg** klorurferik dhe si dezinfektues **38,494 kg** klor i gazët.

***Tabela 30. Sasia e kemikateve të shpenzuara gjatë muajve***

| Muaji | Shipol | Balinc | Shipol | Balinc | Shipol | Balinc | Shipol | Balinc |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Alumin sulfati –kg | | Polielektroliti kg | | Klori gaz kg | | Kloruriferrik kg | |
| Janar | 0 | 0 | 0 | 0 | 1640 | 778 | 4800 | 3584 |
| Shkurt | 0 | 0 | 0 | 0 | 1724 | 656 | 6960 | 2576 |
| Mars | 0 | 0 | 0 | 0 | 1832 | 722 | 6820 | 2340 |
| Prill | 0 | 0 | 0 | 0 | 1900 | 755 | 6730 | 2126 |
| Maj | 0 | 0 | 0 | 0 | 1752 | 818 | 10,060 | 2316 |
| Qershor | 0 | 0 | 0 | 0 | 1765 | 903 | 14,500 | 2968 |
| Korrik | 0 | 0 | 0 | 0 | 1765 | 990 | 14,500 | 2576 |
| Gusht | 0 | 0 | 0 | 0 | 2250 | 1066 | 6000 | 2410 |
| Shtator | 0 | 0 | 0 | 0 | 1806 | 1005 | 6398 | 1960 |
| Tetor | 0 | 0 | 0 | 0 | 1950 | 1005 | 4460 | 1950 |
| Nëntor | 0 | 0 | 0 | 0 | 2104 | 895 | 16680 | 2808 |
| Dhjetor | 0 | 0 | 0 | 0 | 1870 | 837 | 19040 | 6552 |
| Total | 0 | 0 | 0 | 0 | **22,358** | **10,430** | **116,948** | **34,166** |
| Gjithesej dy ITU-të | 0 | | 0 | | **32,788** | | **151,114** | |

## 5.4 ITUN në Skenderaj

**ITUZ në Skenderaj- gjatë tre mujorit të katërt**, janë trajtuar **158,598 m³** ujëra të zeza. Gjatë tre mujorit të tretë nuk ka pasur probleme teknike. Në laboratorin e impiantit merren 12 mostra dhe janë analizuar 27 parametra, nga secila mostër dhe uji i trajtuar i plotëson kriteret për tu derdhur në lumë.

## *5.5 Raport i Njësive Operative*

**Raport i Njësive Operative- Raport i Njësive Operative-** gjatë tre mujorit të parë tri njësitë operative janë furnizuar me ujë me **5,160,000 m³**, ndërsa për Komunat Veriore, Mitrovica e Veriut, Zveçan,së bashku me fshatin Suhodoll është furnizuar me **1,017,785 m³**,siç shihet në tabelën më poshtë.

***Tabela 31 Furinizimi me ujë sipas njësive operative***

| Muaj | Mitrovica (J) | Vushtrri | Skenderaj | Mitrovica (V) | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| TM 1 | 2,859,610 | 1,744,699 | 612,000 | 1,358,393 | 6,574,902 |
| TM 2 | 2,798,513 | 1,928,915 | 725,308 | 1,408,887 | 6,861,623 |
| TM 3 | 3,055,301 | 2,067,673 | 750,593 | 1,442,429 | 7,315,996 |
| TM 4 | 2,846,764 | 1,622,886 | 690,350 | 1,017,785 | 6,177,785 |
| Totali | **11,560,188** | **7,364,173** | **2,778,451** | **5,227,494** | **26,930,306** |

**Njësite Operative Mitrovicë ,Vushtrri dhe Skenderaj** - gjatë tre mujorit, kanë pranuar 891 ankesa sic shihet në tabelën në vijim, prej të cilave 471 ankesa kanë qenë rrjetit të ujit dhe 420 kanë qenë për mirëmbajtje të rrjetit të kanalizimit.

Njësitë Operative, gjatë tre mujorit të parë, kanë qenë aktive në riparime të rrjetit të ujit, dhe në parandalimin e keqpërdorimit të ujit. Mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit, po arrihet që të përfundohen ankesat e konsumatorëve me sukses.

## *5.6 Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve*

Sektori i mirëmbajtjes së automjeteve ka kryer aktivitetet të cilat kanë ndikuar në mënyrë që njesitë operative të jenë në nivel.

*Tabela 212. Parametrat e mirëmbajtjeve të rrjetit të ujit dhe kanalizimit TM2*

| Nr | Njesitë Operative | Njësia | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Parametrat e rrjetit te ujit | | | | | |
| 2 | Nr.i ankesave | nr | 182 | 142 | 147 | 471 |
| 3 | Nr.i ankesave të realizuara | nr | 182 | 142 | 147 | 471 |
| 4 | Nr.i ankesave të pa realizuara | nr | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Numri i prishjeve në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr | 116 | 117 | 90 | 323 |
| 6 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr | 116 | 117 | 90 | 323 |
| 7 | Numri i prishjeve në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr | 66 | 25 | 53 | 144 |
| 8 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr | 66 | 25 | 53 | 144 |
| 9 | Gjatesia e rrjetit të ujësjellësit | M | **1,651,966** | **1,651,966** | **1,651,966** | **1,651,966** |
| 10 | Kyçje të reja në ujësjellës | nr | 12 | 40 | 7 | 59 |
| 11 | Montimi i ujëmatësve | nr | 12 | 47 | 7 | 66 |
| 12 | Riparimi i ujëmatësve | nr | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 13 | Gjatësia e gypit të zëvendësuar | M | 21 | 208 | 82 | 311 |
| | **Rrjeti i kanalizimit** | | | | | |
| 1 | Ankesat | nr | 119 | 139 | 162 | 420 |
| 2 | Ankesat e realizuara | nr | 119 | 139 | 162 | 420 |
| 3 | Ankesat e pa realizuara | nr | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Nr. i përgjithshëm i pusetave të kanalizimit | nr. | **3,980** | **3,980** | **3,980** | **3,980** |
| 5 | Nr. i pusetave të kanalizimit të inspektuara | nr. | 48 | 57 | 56 | 161 |
| 6 | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit të pastruar | M | 8,397 | 4,961 | 7,926 | 21,284 |
| 7 | Numri i bllokimeve në kanalizim | nr./cop | 98 | 65 | 93 | 256 |
| 8 | Gjatësia e rrjetit të kanalizimit | M | **282,201** | **282,201** | **282,201** | **282,201** |
| 9 | Kyçje të reja në kanalizim | nr/copë | 0 | 7 | 5 | 12 |
| | | | | | | |

## 5.6 Planifikimi & Zhvillimi

*Tabela 33. Të dhënat e inkorporuara në GIS*

| Përshkrimi | 01.10.2025-31.12.2025 |
|---|---|
| Nr.i konsumatorëve në sistemin e faturimit | 56,535 |
| Nr.i konsumatorëve në GIS | 54.020 |
| Diferenca mes Faturimit -GIS | 2,515 |
| Nr.i konsumatorëve që kanë nevojë për verifikim-GIS | 45 |
| Konsumatorët : | 95.55.% |
| Nr. I burimeve të ujit /marrjes -GIS | 1 |
| Rrjeti primar dhe sekondar | 91.54% |
| Nr. i FPU-GIS | 4 |
| Nr.Rezervuarëve -GIS | 66 |
| Nr.Stacioneve të Pompimit -GIS | 45 |
| Nr. i valvuleve operuse -GIS | 804-të hapura<br>15-të mbyllura |
| Nr. i valvuleve të ajrimit -GIS | 48 |
| Nr. i valvulave të redukimit të shtypjes -GIS | 14 |
| Nr.ujëmatësave zonal -GIS | 126 |
| Hidrant-GIS | 60 |
| Defektet-GIS | 1,147 |
| Pompa-GIS | 91 |
| Ujëmatësa në prodhim-GIS | 5 |
| Rrjeti i kanalizimit -GIS | 264.157km |
| Nr.Pusetave te kanalizimit-GIS | 7057 |
| Nr. defekteve -GIS | 1515 |

*Tabela 224. Kërkesat/Ankesat*

| Nr. | Përshkrimi i kërkesave | Viti 2025 | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | X | XI | XII | totali |
| 1 | Numri i kërkesave te pranuara | 120 | 91 | 78 | 289 |
| 2 | Shqyrtimi i kërkesave | 118 | 85 | 75 | 278 |
| 3 | Kërkesa për Kyçje | 4 | 1 | 1 | 6 |
| 4 | Kërkesa për Ri- Kyçje | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Kërkesa për Legalizim | 60 | 42 | 38 | 140 |
| 6 | Kërkesa për ndërtesa shumëkatëshe | 1 | 2 | 3 | 6 |
| 7 | Kërkesa për pëlqime | 27 | 10 | 4 | 41 |
| 8 | Detektimi dhe hulumtimi i rrjedhjeve me aparatur-Mitrovicë | 25 | 30 | 27 | 82 |
| 9 | Hulumtimi i rrjedhjeve ne menyrë vizuele | 1 | 0 | 2 | 3 |
| 10 | Evidentimi i konsumatorve në sistemin Gis për kyçje, Legalizime dhe pëlqime. | 118 | 85 | 75 | 278 |

### 5.7 Punimet dhe Zhvillimet për Pjesë Veriore

*Dëshmi për Kapacitete Teknike, Menaxheriale dhe Operative për Mbulesën e Zonës së Re*

### Dëshmi për Kapacitete Teknike, Menaxheriale dhe Operative për Mbulesën e Zonës së Re

Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Mitrovica' Sh.A, në përputhje me zgjerimin e përgjegjësive në komunat veriore, shpreh përmes këtij dokumenti gatishmërinë teknike, menaxheriale dhe operative për të mbuluar zonën e re të shërbimit.

### 1. Funksioni Aktual

Aktualisht kompania jonë ka funksionalizuar strukturën organizative sipas planit operativ të miratuar. Janë të hapura konkurset për pozitat e parashikuara në këtë plan, të cilat do të përforcojnë më tej kapacitetin e shërbimit në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

### 2. Fabrika e Ujit në Zubin Potok

Fabrika e ujit në Zubin Potok operon me ndërrrime 24-orëshe, me përfshirjen e tri kompanive rajonale:

- Dy ndërrime mbahen nga KRU Mitrovica,
- Një nga KRU Prishtina,
- Një nga KRU Gjakova.

Ekipet operacionale përbëhen nga operatorë teknikë, laborantë për kontrollin e cilësisë së ujit dhe dozatorë për menaxhimin e kimikateve. Menaxheri i fabrikës së Shipolit është përgjegjës për mbikëqyrjen e operimit, ndërsa mbështetja teknike sigurohet nga ekipi i elektromakinerisë së KRU Mitrovica.

Deri më tani, funksionimi është realizuar pa ndonjë pengesë operacionale.

### 3. Menaxhimi i Njësive në Veri

Menaxhimi i operacioneve në komunat veriore bëhet në mënyrë të koordinuar nga një koordinator i caktuar për zonën e veriut, nga shefi i rrjetit dhe ekipet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujit. Ndërkohë, mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit për këtë zonë mbulohet nga ekipi teknik që operon nga jugu.

Operimi i plotë dhe normal i njësive në komunat veriore pritet të fillojë së shpejti, pasi kompania ka hapur tashmë konkurset për të gjitha pozitat e parashikuara në planin operativ. Me përfundimin e procesit të rekrutimit, strukturat e reja do të jenë të gatshme për të marrë përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse, duke siguruar kontinuitet dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në zonën e re të menaxhimit.

Në përfundim, KRU 'Mitrovica' Sh.A konfirmon se posedon kapacitete të mjaftueshme teknike, menaxheriale dhe njerëzore për të ofruar shërbime të qëndrueshme në zonën e re të menaxhimit, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga ARRU dhe institucionet përkatëse.

***Tabela 35. Intervenimet në rrjetin e ujit –TM4***

| Nr | Njësitë Operative | Njësi | Tetor | Nëntor | Dhjetor | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **RRJETI I UJËSJELLËSIT** | | | | | |
| 2 | Nr. I ankesave | Nr/copë | 51 | 38 | 35 | 124 |
| 3 | Nr.i ankesave të realizuara | nr./copë | 51 | 38 | 35 | 124 |
| 4 | Nr.i ankesave të pa realizuara | nr./copë | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Numri i prishjeve në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr./copë | 25 | 29 | 18 | 72 |
| 6 | Numri i prishjeve të riparuara në gypat kryesor të ujësjellësit nën Ø63mm | nr./copë | 25 | 29 | 18 | 72 |
| 7 | Nr.i prishjeve në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr./copë | 26 | 9 | 17 | 52 |
| 8 | Nr. i prishjeve të riparuara në gypat e kyçjes së ujësjellësit mbi Ø63mm | nr./copë | 26 | 9 | 17 | 52 |
| | **RRJETI I KANALIZIMIT** | | | | | |
| 1 | Ankesat | nr | 10 | 22 | 6 | 38 |
| 2 | Ankesat e realizuara | nr | 10 | 22 | 6 | 38 |
| 3 | Numri i bllokimeve në kanalizim | nr./copë | 10 | 22 | 6 | 38 |

***Tabela 36. Distribuimi i ujit nga ITU [3]***

| Uji i prodhuar- ITU | Zubin Potok m³ | l/s |
|---|---|---|
| Tetor | 361,584 | 135.0 |
| Nëntor | 363,169 | 140.1 |
| Dhjetor | 353,548 | 132.0 |
| Total (TM4) | 1,078,301 | |

*Tabela 37. Distribuimi i ujit sipas vendbanimeve*

| Shpërndarja e sasisë së ujit nëpër komunat veriore ($m^3$) | Mitrovicë-Veri *(nje pjese)* | Zveqani | Banov-Zhirovnic | Kruzhnitok | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| **Tetor** | 264,268 | 68,746 | 9,822 | 18,748 | 361,584 |
| Nëntor | 244,944 | 95,904 | 9,590 | 12,731 | 363,169 |
| **Dhjetor** | 249,163 | 92,219 | 3,838 | 8,328 | 353,548 |
| Totali | **758,375** | **256,869** | **23,250** | **39,807** | **1,078,301** |

## 6. IMPIANTI PËR TRAJTIMIN E UJRAVE TË ZEZA – PROJEKTI

| | |
|---|---|
| Projekti: | **ID e Projektit: 50458 "Ndërtimi i Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza- Mitrovicë" - Vushtrri** |
| Implementues: | *Kompania Regjionale Ujësjellësi -Mitrovicë* |
| PA Lokacioni: | *Mitrovicë, Kosovë* |
| Datë: | *TM4 2025* |

ID e Projektit: 50458
**https://ecepp.ebrd.com/**
**Project: Mitrovica Wastewater Development Project**
**Procurement Exercise: Project Implementation Consultant - Wastewater**
**ECEPP ID**: 15306482
**http://www.kru-mitrovica.com/trajtimi-i-ujerave-te-zeza/**

**Aktivitetet e Përfunduara**

U percaktua vendodhja per ndertimin e Impiantit

**Vendndodhja e ITUN**

Pasi te gjitha palët e përfshira ne projekt u pajtuan me Analizën - studimin e alternativave se, M1 është vendodhja e preferuar per ndërtim te ITUN nga Konsulenca u kërkua perditesimi i dokumentacionit. Gjithashtu u vendos se - Fillimi i procedurave të transferimit të tokës është një parakusht për nisjen e prokurimit.

**Statusi Aktual**

Konsulenca eshte angazhuar që te bëj përditësimet e koncept dizajnit te Impiantit dhe rrjetit te kanalizimit ne përputhje me rrethanat e reja dhe përshtatja me lokacionin e ri – M1, Aktualishte kane filluar me viziten ne teren.

**Zgjerim**

**- Faza e dyte (II).**

Ministria e Financave ne takimin e mbajtur më 12 gusht 2025 me përfaqësues të BERZH-it dhe Ambasadorin e Suedisë, u pajtuan për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Ndotura të Mitrovicës - Zgjerimi i projektit për të përfshirë dy komunat veriore, Mitrovice e veriut dhe Zvecanin duke siguruar lidhje të plotë me Mitrovicën Jugore. BERZH do të finalizojë ToR për Studimin e Fizibilitetit

të fazës së dytë të projektit (ku Mitrovica Veriore dhe Zveqani do të lidhen me sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura).

**FOPIP** - Përmasimi i Performances Tekniko-Financiare ECEP ID:39413763

Ne kuadër te Projekteve te financuara nga BERZH_i si pako shkon edhe FOPOI_i (Përmasimi i Performances Operative dhe Financiar te Kompanisë) qe financohet nga një grant ne vlere 337,500 euro nga shtetit i Zvicrës (Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) përmes agjencionit SECO. Jane hapur ofertat me 26.11.2025, komisioni ka filluar punene ne vlersimin e ofertave me 05.01.2026.

## 7. ZYRA PËR INFORMIM RAPORTIM DHE MARDHËNIE ME PUBLIKUN

### 7.1 Zyra për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun

Periudha Tetor–Dhjetor 2025 ka qenë një tremujor i pasur me aktivitete dhe angazhime të ndryshme për Zyrën për Informim, Raportim dhe Marrëdhënie me Publikun. Gjatë këtyre tre muajve, stafi ka vazhduar me përkushtim të pandërprerë menaxhimin e komunikimit me qytetarët, duke siguruar **informacion të saktë, transparencë institucionale dhe përgjegjësi profesionale në çdo veprim**.

Ky raport përmbledh **aktivitetet rutinë të tre muajve të fundit** dhe kulmin e tyre me **ngjarjet e turbullirës së ujit dhe ndërprerjeve të Impianteve të Trajtimit**, duke evidentuar rëndësinë e komunikimit të vazhdueshëm dhe koordinimit të stafit në situata kritike.

**Monitorimi dhe informimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit**

- Publikimi i njoftimeve mbi ndërhyrjet dhe punimet e planifikuara ka qenë aktiviteti më i rregullt dhe themelor i Zyres.
- Qytetarët janë mbajtur të informuar mbi ndërprerjet e parashikuara dhe punimet e mirëmbajtjes, duke u mundësuar planifikim të aktivitetve të përditshme.
- Ky proces ka siguruar **kontinuitet dhe qartësi në komunikim**, duke forcuar ndjesinë e sigurisë së komunitetit.

---

**Transparenca dhe qasja e barabartë në procedurat e punësimit**

- Gjatë këtyre tre muajve, publikimi i konkurseve për vendet e lira të punës në të dy gjuhët zyrtare ka garantuar qasje të barabartë ndaj mundësive të punësimit.
- Zyra ka siguruar që çdo proces rekrutimi të jetë i hapur, i drejtë dhe i mbështetur nga informacione të plota për qytetarët.

- Ky angazhim është një **vlerë thelbësore institucionale**, duke pasqyruar përkushtimin ndaj transparencës dhe drejtësisë.

---

**Aktiviteti i ekipeve në terren**

- Ekipet e kontrollit dhe inspektimit kanë zhvilluar punë intensive në rrjet gjatë tre muajve, duke identifikuar parregullsitë dhe duke ndërmarrë masa të menjëhershme për përmirësim.
- Mbikëqyrja e vazhdueshme ka garantuar që vendimet administrative dhe teknike të mbështeten nga **evidencë e drejtpërdrejtë dhe vëzhgime profesionale**.
- Ky aktivitet ka qenë i domosdoshëm për funksionimin efikas të rrjetit dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

**Komunikimi i vazhdueshëm dhe përforcimi i besimit institucional**

- Publikimi i informacionit dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët ka qenë prioritet konstant gjatë tre muajve.
- Përveç njoftimeve rutinë, Zyra ka përdorur **kanale të shumta dhe të koordinuara** për të siguruar që çdo qytetar të marrë informacion të saktë dhe të kohës reale.
- Ky proces ka përforcuar besimin e komunitetit dhe ka krijuar një urë të fortë midis qytetarëve dhe institucionit.

**Ngjarjet e veçanta në Dhjetor – Menaxhimi i turbullirës së ujit**

- Muaji Dhjetor ka shënuar kulmin e tremujorit me **nivela të larta turbullire dhe ndërprerje të përkohshme të Impianteve të Trajtimit të Ujit**.

- Stafi i Zyres ka reaguar me një **menaxhim të integruar dhe komunikim të pandërprerë nga çasti në çast**:
  - Raportimi i zonave të prekura dhe kohëzgjatjes së ndërprerjeve
  - Informimi mbi masat paraprake për qytetarët
  - Përditësime të vazhdueshme mbi zhvillimet dhe progresin e riparimeve
- Ky aktivitet nuk ishte thjesht një përgjigje teknike, por një **veprim strategjik për të ruajtur transparencën, qetësinë dhe besimin publik**, duke e vendosur komunikimin me qytetarët si fokusin kryesor të angazhimit institucional.

## 8. PROKURIMI

***Tabela 38. Aktivitetet e Prokurimit***

| Të Hyra Vetanake (1) ose | Numri rendor i prokurimit | Titulli i aktivitetit të prokurimit | Data e inicimit të aktivitetetit të prokurimit | Data e publikimit të njoftimit për kontratë | Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës | Data e nënshkrimit të kontratës ( ne rast anulimi data e njoftimit për anulim) | Vlera e parashikuar e kontratës | Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj. | Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | KURM-25-8955-2-3-6 | Ofrimi i Shërbimeve Juridike | 30.9.2025. | 2.10.2025. | 23.10.2025. | 22.10.2025. | 5,000 | 4,560.00 | RPHS LAW L.L.C. |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | KURM-25-9090-1-3-6 | Furnizimi me vajra dhe antifriz per automjete e KRUM | 2.10.2025. | 7.10.2025. | 26.11.2025. | 24.11.2025. | 3,000 | 1,474.00 | " Ballkan Petrol " SH.P.K. |
| 1 | KURM-25-9099-1-3-6 | Furnizim me goma për automjetet e KUR Mitrovica Sh.A | 2.10.2025. | 7.10.2025. | 2.12.2025. | 1.12.2025. | 7,000 | 6,030.00 | Goma Pro SH.P.K. |
| 2 | KURM-25-262-1-2-1 | Furnizim me Eskavator | 22.1.2025. | 23.1.2025. | 19.11.2025. | 17.11.2025. | 105,000 | 93,550.00 | Grup i OE BauMachine L.L.C.; Enver Baliu B.I. |
| 1 | KURM-25-10768-2-4-7 | Sigurimi i Automjeteve te KRU-Mitrovica Sh.A | 26.11.2025. | n/a | 28.11.2025. | 27.11.2025. | 990 | 918.04 | KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A. |
| 1 | KURM-25-11026-2-3-6 | Sigurimi i Automjeteve te KRU-Mitrovica Sh.A RI tenderi II | 5.12.2025. | 8.12.2025. | 25.12.2025. | 24.12.2025. | 9,500 | 6,529.16 | KOMPANIA E SIGURIMEVE EUROSIG SH.A. |
| 1 | KURM-25-11056-1-3-6 | Furnizim me reagensa dhe enë për laborator Ri tender II | 5.12.2025. | 8.12.2025. | 1.1.2026. | 30.12.2025. | 9,800 | 9,503.70 | Flamur Isufi B.I. |
| 1 | KURM-25-11506-1-4-7 | Furnizim dhe montim me Klima Inverter 24BTU | 24.12.2025. | n/a | 30.12.2025. | 29.12.2025. | 900. | 630.00 | AS Tech SH.P.K. |